

		<b>DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING</b> REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA	
Mihistria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Nr. Br. No.	454-549/11	Data. Datum. Date.	27.06.2023
E			
Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria - Vlada – Government Ministratë e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave Ministry of Local Government Administration			

27.06.2023  
02-576



Komuna Shtime  
Opština Štimlje

	<b>Municipality of Shtime</b> REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E SHTIMES/OPŠTINA ŠTIMLJE
Nr i Prot/Br. Prot	02/95
Nr i Faqeve/Br.strana	8
Data/Data:	27.06.2023
SHTIME/ŠTIMLJE	

### Marrëveshje

ndërmjet

**Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal**

**Republika e Kosovës,**

dhe

**Komunës së Shtime**

("palët")

**Numri i regjistrimit: \_\_\_\_\_**

**Vendi: \_\_\_\_\_**

Në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës,

Marrëveshja është në përputhje me termat dhe kushtet për zbatimin e projektit, të përcaktuara në marrëveshjen e grantit të datës 27 shkurt 2020 ndërmjet Bankës Botërore dhe Republikës së Kosovës ("përfituesi").

Përfituesi do të implementojë projektin përmes MAPL ("organi zbatues i projektit") në bashkëpunim me komunat e zgjedhura.

**Kjo Marrëveshje është arritur ndërmjet palëve vijuese:**

**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL**, me adresë në Prishtinë, ish-ndërtesa  
“Rilindja”, kat 11-13, përfaqësuar nga Elbert Krasniqi, Ministër (në tekstin e mëtejmë:  
“Ministria”);

**dhe**

**Komuna e Shtimes**, me adresë Rruga “Tahir Sinani”, Shtime 72000, përfaqësuar nga z. Qemajl  
Aliu, Kryetari i Komunës, në tekstin e mëtejmë "Komuna";

**Neni 1**

## **Shkurtesat**

1. **Marrëveshje** – Marrëveshja e zbatimit
2. **MAPL** – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
3. **Donatorët** – Qeveria e Japonisë ("Donatori") në kuadër të Fondit Japonez për Zhvillim Social
4. **OJQ-PF** – Organizata Jo-qeveritare që është Pikë Fokale
5. **MOP** - Manuali i Operimeve të Projektit
6. **NJMP** – Njësia e Menaxhimit të Projektit
7. **MNG** - Manuali i Nën-Grantit
8. **Banka Botërore** - Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
9. **Komuna** – Komuna e Shtimes

## **Neni 2**

### **OBJEKTIVI I MARRËVESHJES**

1. Palët dakordohen për zbatim të Projektin Komunat për Rini (M4Y) ("Projekti") në Kosovë, financuar me grant të Qeverisë së Japonisë ("Donatori") në kuadër të Fondit Japonez për Zhvillim Social në përputhje me dispozitat e përcaktuara në marrëveshje. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore") do të veprojë si administrator i fondeve të granteve të dhëna nga Donatori. Marrëveshja është në përputhje me termat dhe kushtet për zbatimin e projektit, të përcaktuara në marrëveshjen e grantit ndërmjet Bankës Botërore dhe Republikës së Kosovës ("përfituesi"). Përfituesi do të implementojë projektin përmes MAPL-së ("organi zbatues i projektit") në bashkëpunim me komunat e zgjedhura. Kjo marrëveshje duhet të lexohet së bashku me Manualin e Operimeve të Projektit (MOP) dhe nuk synon të ndryshojë/zëvendësojë dispozitat e MOP, por ajo duhet të lexohet/kuptohet si pjesë e MOP.

## **Neni 3**

### **TERMET E PËRGJITHSHME**

1. Komuna deklaron zotimin e saj për objektivat e Projektit të zbatuara nga MAPL.

2. Palët që janë pjesë e Marrëveshjes do të kryejnë aktivitetet e Projektit në përputhje me përgjegjësitë e dhëna atyre në këtë Marrëveshje.
3. Gjatë realizimit të aktiviteteve të Projektit, Palët në Marrëveshje do t'i përbahen (i) "Udhëzimeve për Parandalimin dhe Luftimin e Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga Kreditë e BNRZH-së dhe Kreditë dhe Grantet e AZHN", të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar të vitit 2011 dhe më 1 korrik 2016 ("Udhëzuesi Anti-Korrupsion"); (ii) dhe të rishikuar në nentor 2017 dhe gusht 2018 ("Rregulloret e Prokurimit").
4. Çdo ndryshim në marrëveshje do të jetë i vlefshëm nëse i njëjtë bëhet me shkrim dhe nënshkruehet nga të dyja Palët dhe miratohet nga Banka Botërore.

#### Neni 4

#### **AFATI I MARRËVESHJES DHE PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM**

1. Kjo Marrëveshje është e vlefshme deri më 31 Korrik 2024 (data e mbylljes së MFY) dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët;
2. Në rast të dështimit të komunës për të përbushur detyrimet e saj që burojnë nga kjo Marrëveshjeje, atëherë MAPL ka të drejtë të përfundojë në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen dhe të rialokojë fondet me njoftim paraprak në kohë prej 1 muaj; MAPL mund të pezullojë dhe pezullojë të drejtën e përfituesit për përdorimin e të ardhurave të financimit nëse nuk arrin të kryejë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.
3. Mosbatimi i kësaj marrëveshje nga ana e Komunës do të rezultojë në ndërprerjen e mbështetjes financiare nga MAPL për vitin vijues.
4. Në rast se MAPL nuk i përbush detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, Komuna ka të drejtë të përfundojë në mënyrë të njëanshme këtë Marrëveshje, me njoftim paraprak në kohë prej 1 muaj;

#### Neni 5

#### **FORCA MADHORE**

1. Palët lirohen nga përgjegjësia për mospërbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse mospërbushje e përmendur shkaktohet nga rrethana përtej kontrollit të tyre të arsyeshëm siç janë: katastrofat natyrore dhe çdo ngjarje tjetër e paparashikueshme dhe e provuar gjëresisht. Pala e cila nuk është në gjendje të përbushë detyrimet e saj sipas Marrëveshjes do të njoftojë Palën tjetër lidhur me rrethanat e mësipërme brenda 48 orëve nga ngjarjet e tillë.
2. Nëse rrethanat e forcës madhore zgjasin më shumë se gjashtë muaj, atëherë secila Palë vendos për të ardhmen e Marrëveshjes.

#### Neni 6

## ZGJIDHJA E KONTESTEVE

1. Çdo mosmarrëveshje, kontest ose mospërputhje që mund të dalë nga kjo Marrëveshje midis Palëve, do të zgjidhet përmes negociatave midis Palëve.
2. Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje, rasti i pazgjidhur do të zgjidhet në gjykatë, në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

## Neni 7

### FINANCIMI PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE NË RASTIN E NËN-PROJEKTEVE

#### 1. Obligimet e Ministrisë

- 1.1 MAPL-ja, në koordinim me Komunën, alokon financimin e nën-projekteve për të rindjtë në dy runde çdo vit.
- 1.2 MAPL-ja alokon financimin për nën-projekte për rini sipas një formule për shpërndarjen e fondeve, e cila i vihet në dispozicion Komunës<sup>1</sup>.
- 1.3 MAPL do të financojë 85% të vlerës totale të nën-projektit të propozuar prej **70,000.00 dollarë** përmes alokimeve të saj buxhetore.
- 1.4 MAPL do t'i bëjë pagesat drejtpërdrejt përfituesit ose shitësve dhe/ose do të mbështesë prokurimin për punë, mallra dhe shërbime në përputhje me propozimin për nën-grante.

#### 2. Obligimet e Komunës

- 2.1 Komuna siguron që ka financim të barabartë me të paktën 15% të nën-grantit komunal të propozuar prej **10,500.00 dollarë**. Kërkohen prova të fondeve të rezervuara të përputhshme.
- 2.2 Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për nën-grante, Komuna shpërndan fondet përkatëse tek përfituesit në formë të paradhënieve së parë të nën-grantit.
- 2.3 Komuna, me kujdes dhe efikasitet të duhur, kryen dhe operon objektet të cilat përfitojnë nga financimi, në përputhje me (1) standartet e shëndosha teknike, financiare dhe standartet menaxheriale (përfshirë mirëmbajtjen e registrave adekuat), (2) standartet e zbatueshme mjedisore dhe të ndikimit shoqëror në përputhje me kërkuesat e përcaktuara në MOP, Kapitulli 6, (3) dispozitat e Udhëzuesve Antikorrupsion
- 2.4 Komuna siguron që të gjitha financimet të përdoren ekskluzivisht për financimin e shpenzimeve të pranueshme siç specifikohet në MNG në lidhje me Shpenzimet Operative të NVM-ve dhe Shpenzimet Operative të Firmave Inovative të të Rinjve

## Neni 8

### PËRGATITJA, ZBATIMI DHE FUNKSIONIMI I NËN-PROJEKTEVE, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

<sup>1</sup> MANUALI I NËNGRANTEVE (MNG), 2.3 Formula e Shpërndarjes së Fondeve, Shpërndarja e Bands sipas rezultateve të MPS-së të vitit 2019 dhe Komunave sipas Rezultateve të Performancës, Popullsisë së Rinisë dhe shumave të bashkëfinancimit të aprovuara nga BB.

## **1. Obligimet e Ministrisë**

- 1.1 MAPL harton planin për ngritjen e kapaciteteve bazuar në nevoja, në mënyrë që të lehtësojë mbështetjen për komunën lidhur me iniciativat e komunitetit të udhëhequra nga të rinjtë dhe të sigurojë burime për zbatimin e planit.
- 1.2 MAPL siguron trajnime, bursa dhe mentorim për vullnetarët nga radhët e komunitetit të vendosur në Komunë për të punuar në programin e nën-granteve dhe aktivitete të tjera rimore.
- 1.3 MAPL cakton anëtarin e Komitetit të Vlerësimit të Projektit të propozuar nga Komuna.
- 1.4 Komunat do të trajnohen nga NJMP e MPL dhe OJQ-PF për të mbështetur përfituesit gjatë procedurave të tenderit.
- 1.5 MAPL ndan me Komunën të gjitha raportet e progresit për implementimin e nën-projekteve, duke përfshirë këtu raportet e përgatitura nga monitoruesit e të rinteve dhe OJQ-të partnere lehtësuese.

## **2. Obligimet e Komunës**

- 2.1 Komuna siguron hapësirën, transportin dhe aspektet tjera logistike për takime dhe ngjarje të projektit.
- 2.2 Komuna angazhon staf me 40 orë në muaj për të lehtësuar përgatitjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e nën-projekteve. Inxhinierët, zyrtarët ronorë, kontabilistët dhe personeli tjetër përkates do të përfshihen në këto aktivitete.
- 2.3 Komuna zhvillon programe individuale të punës për të rinjtë nga radhët e komunitetit, siguron hapësirë të punës, qasje në kompjuterë të punës dhe mbulon të gjitha shpenzimet logistike dhe administrative të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve në kuadër të programit të punës.
- 2.4 Komuna themelon komisionin e vlerësimit të nën-projektit, organizon thirrje për propozime dhe shpall fituesit.
- 2.5 Komuna përkrah mbështetësit e investimeve kapitale për marrjen e lejeve mjedisore, ndërtimore dhe/ose lejeve të tjera zyrtare që mund të janë të nevojshme.
- 2.6 Komuna siguron që investimet e propozuara të janë në përputhje me planet zhvillimore lokale.
- 2.7 Komuna bën mbikëqyrje të rregullt të nën-projekteve të investimeve kapitale dhe raporton në MAPL lidhur me çdo parregullsi në implementim, duke përfshirë ato të cilat janë të ndërlidhura me mbrojtjen e mjedisit.
- 2.8 Komuna jep certifikata për të gjithë vullnetarët e projektit si njohje e përvojës së tyre të punës.
- 2.9 Komuna është përgjegjëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e tërë infrastrukturës komunale dhe pajisjeve të finançuara nga Projekti.
- 2.10 Procedurat e prokurimit për nën-grantet do të kryhen nga përfituesit e granteve me mbështetjen e Organizatës(ave) Jo-Qeveritare që janë Pikë(a) Fokale (OJQ-PF).
- 2.11 Për investime kapitale që përfshijnë asete komunale, komuna do t'i japë përfituesit pëlgimin paraprak dhe prokurimi do të kryhet nga ana e përfituesit me mbështetjen e Njësisë për Menaxhimin e Projekteve të MAPL-së (NJMP) siç përshkruhet në MNG.
- 2.12 Komuna lejon inspekthin nga ana e përfaqësuesve të Bankës Botërore të vendeve përfituese dhe shpenzimeve të finançuara nga financimi, të operimeve në fjalë dhe të çdo

regjistri dhe dokumenti të rëndësishëm; dhe siguron që i gjithë informacionin i tillë që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me atë që u tha më lartë dhe me administratën, operimet dhe gjendjen financiare të përfituesit dhe me përfitimet që do të vijnë nga financimi.

2.13 Monitoruesit e të rinxve nga secila komunë do të emërohen për të kryer role aktive pjesëmarrëse të monitorimit dhe mbikëqyrjes me qëllim të kontrollimit të progresit të zbatimit kundrejt qëllimeve të deklaruara.

## Neni 9

### VIZIBILITETI I PROJEKTIT

#### 1. MAPL

1.1 MAPL së bashku me OJQ-PF organizon Forumet Rinore (në vitin e 2-të dhe të 3-të) çdo vit, me qëllim të shkëmbimit të rezultateve dhe mësimeve të nxjerra nga projekti, duke përfshirë mbështetjen komunale dhe orientimin e të rinxve.


1.2 Sa i përket materialit te projektit, MAPL i referohet financimit dhe mbështetjes se komunës.

#### 2. Komuna

2.1 Komuna njofton fillimin e thirrjeve për propozime për nën-grante dhe organizon ceremonitë e dhënieve së granteve.

2.2 Komuna lehtëson organizimin e forumeve komunale ku prezantohen buxhetet, shpenzimet dhe progresi drejt objektivave.

#### NËNSHKRIMET DHE DETAJET E PALËVE

<p>Elbert KRASNIQI Ministria e Administrimit të Pushtetit <b>Lokal</b>  (Nënskrimi i Ministrit)</p> <hr/> <p>(Data)</p>	<p>Qemajl ALIU Komuna e Shtimes  (Nënskrimi i Kryetarit)</p> <p> (Data)</p>
--	--